



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2992/2 prot.,

Datë 04.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar” me nr. REF – 86468-11-06-2023, me objekt: “*Shërbim mirëmbajtje karikues elektrik, Marrëveshje kuadër për 2 vite*”, me fond limit 9,000,000 (nëntë milion) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

Ankimues:

“TETRA” SHPK me NIPT K72017027P dhe adresë, Rruga gjin Bue Shpata, P.2/1, Ap.2, Nj.Bashkiake nr.5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare sh.a. me adresë Rruga “Reshit Çollaku” Nr. 4, Tiranë

Në datën 01.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3663 dhe me nr. 2992/2023 prot., datë 01.12.2023 e operatorit ekonomik “TETRA” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TETRA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “TETRA” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Referuar dokumentave në tender rezulton që nuk përmbush kriterin 2.3.1: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 19% e vlerës limit të kontratës që prokurohet". Operatori ekonomik ka paraqitur në sistem Kontratën nr.prot 2240/10 datë 18.01.2021 si dhe vërtetimin për realizim kontrate nr.prot 1914/1 datë 20.09.2022. Në "vërtetimin e realizimit të kontratës" është cituar kontratë me objekt blerje dhe jo shërbim mirëmbajtje ku nuk janë specifikuar zërat apo vlera e realizuar nga ky operator, si rrjedhojë është e pamundur që si komision vlerësimi të ofertës të vërtetohet se operatori ekonomik ofertues Tetra shpk ka realizuar shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës limit që prokurohet . Në kontratën me nr.prot 2240/10 datë 18.01.2021 të paraqitur në sistem konstatohet se operatori ekonomik Tetra shpk ka qenë pjesë e një bashkimi operatorësh ekonomik (BOE) me operatorin ekonomik R.S.&M. Në këtë kontratë nuk është përcaktuar e ndarë se çfarë zërash janë për blerje karikuesish elektrikë si dhe çfarë zërash për shërbim mirëmbajtje. Gjithashtu nuk ka të bashkëlidhur një marrëveshje bashkëpunimi mes tyre ku të përcaktohen qartë zërat si dhe vlera përkatëse.

Bazuar edhe në ekstraktin historik të operatorit ekonomik Tetra shpk vihet re se objekti i veprimtarisë për shërbim mirëmbajtje të sistemeve karikuesish elektrikë është bërë në 28.09.2023. Pra sqarohet se në kontratën nr.prot 2240/10 datë 18.01.2021 nuk e ka pasur objekt të veprimtarisë mirëmbajtje sistemi karikuesish elektrikë, edhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet shërbim i ngjashëm gjatë tre viteve të fundit

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri